

Komisioni për Mbrojtje të Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) nga Ligji për Mbrojtje të Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga RWA Raiffeisen Ware Austria Handel und Vermögensverwaltung eGen, me seli të regjistruar në Raiffeisenstraße 1, 2100 Korneuburg, Austri, përmes përfaqësueses me autorizim Ljupka Noveska Andonova, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 12.03.2025, e solli këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin RWA Raiffeisen Ware Austria Handel und Vermögensverwaltung eGen, me seli të regjistruar në Raiffeisenstraße 1, 2100 Korneuburg, Austri do të fitojë kontroll të pavarur mbi RWA Raiffeisen Ware Austria Aktiengesellschaft, me seli të regjistruar në Raiffeisenstraße 1, 2100 Korneuburg, Austri, duke përfshirë shoqëritë e varura të saj, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose prishjen e konsiderueshme të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptimin e nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksa administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës (në vazhdim: Ligji), më datë 05.02.2025, e plotësuar më 07.02.2025, te Komisioni për mbrojtje të konkurrencës (në vazhdim: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga RWA Raiffeisen Ware Austria Handel und Vermögensverwaltung eGen, me seli të regjistruar në Raiffeisenstraße 1, 2100 Korneuburg, Austri, me të cilin RWA Raiffeisen Ware Austria Handel und Vermögensverwaltung eGen do të fitojë kontroll të pavarur mbi RWA Raiffeisen Ware Austria Aktiengesellschaft, me seli të regjistruar në Raiffeisenstraße 1, 2100 Korneuburg, Austri, duke përfshirë edhe shoqëritë e saj të varura.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimeve dhe shtojcave të njëjta, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

RWA Raiffeisen Ware Austria Handel und Vermögensverwaltung eGen është një kooperativë bujqësore që funksionon si shoqëri holding. Nuk është vetë aktive ekonomikisht dhe për këtë arsye nuk realizon shitje.

RWA Raiffeisen Ware Austria Aktiengesellschaft (ose Grupi RWA (RWA Group)) është një konglomerat i shoqërive që merren me prodhim, tregti dhe shërbime, dhe që është kryesisht aktiv në tregtinë me shumicë në fushën e blerjes dhe shitjes në sektorin bujqësor të produkteve bujqësore, mallrave (p.sh. fara, pesticide, plehra, ushqim për kafshë), mallrave të konsumit (veçanërisht materiale ndërtimi dhe produkte për shtëpi dhe kopsht), energjisë si dhe teknologjisë bujqësore dhe pjesëve rezervë. Për më tepër, ka një sistem franshize në fushën e teknologjisë bujqësore, si dhe për materiale ndërtimi dhe tregun për shtëpi dhe kopsht (DIY).

Grupi RWA nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut, por gjatë vitit të kaluar ka realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut nga shitja e ushqimit për kafshë, veçanërisht ushqim i koncentruar për kafshë, aditivë ushqimorë, ushqim për peshq dhe mallra të zakonshme bujqësore siç janë fara, mjete për mbrojtjen e bimëve, plehra, etj.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ

